



FONDI KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE
KOSOVSKI FOND ZA KREDITNO JEMSTVO
KOSOVO CREDIT GUARANTEE FUND

POLITIKA E MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL

TABELA E PËRMBAJTJES

POLITIKË TË MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL	4
KAPITULLI I.....	4
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME.....	4
Neni 1.....	4
Hyrje.....	4
Neni 2.....	4
Qëllimi dhe fushëveprimi	4
Neni 3	5
Përkufizimet	5
KAPITULLI II.....	7
ZBATIMI I KËRKESAVE TË POLITIKËS SË MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL	7
Neni 4.	7
Autoriteti dhe Përgjegjësitë	7
Neni 5.	7
Zbatimi i Sistemit të Menaxhimit Mjedor dhe Social nga IF-të	7
Neni 6.	8
Përfshirja e Palëve të Interesit në Menaxhimin e Rreziqeve Mjedisore dhe Sociale	8
Neni 7.	8
Legjislacioni i Aplikueshëm Mjedor, Social, i Shëndetit dhe i Sigurisë	8
Neni 8.	9
Standardet e Zbatueshme Ndërkombëtare Mjedisore dhe Sociale	9
Neni 9.	10
Standarde të tjera Mjedisore dhe Sociale të rëndësishme, por jo të zbatueshme për FKGK .	10
Neni 10	10
Sektorët e ndaluar, kufizuar dhe qëllimet e kredisë	10
Neni 11	12
Kategorizimi i Risqeve Mjedisore dhe Sociale.....	12
Neni 12	13
Dokumentacioni për Vlerësim Mjedor	13
Neni 13	14
Mekanizmi i Ankesave	14
Neni 14	14

Monitorimi dhe Raportimi	14
KAPITULLI III.....	16
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE	16
Neni 15	16
Implementimi i Politikës.....	16
Neni 16	16
Ndryshimet në këtë Politikë	16
Neni 17	16
Dispozitat shfuqizuese.....	16
Neni 18	16
Pajtueshmëria dhe Sanksionet.....	16
Neni 19	17
Shtojcat.....	17
Neni 20	17
Hyrja në fuqi	17
Shtojca I	18
Sektorët intensivë të karbonit të listuar sipas kodeve NACE.....	18
Shtojca II	19
Aktivitetet e ndaluar sipas kodeve NACE	19
Shtojca III	20
Formulari i Vlerësimit të Riskut Mjedisor dhe Social	20
Shtojca IV.....	29
Rrjedha Gjenerike e Procesit të Miratimit të Kredisë	29
Shtojca V.....	30
Projektet e renditura në Shtojcën 1 të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, që i nënshtrohen procedurave të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis	30
Shtojca VI.....	35
Projektet e renditura në Shtojcën II të Ligjit kombëtar të Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor ...	35
Shtojca VII.....	38
Lista e aktiviteteve që i nënshtrohen Lejes Mjedisore Komunale	38

Bordi i Drejtorëve të Fondit Kosovar për Garanci Kreditore;

Në bazë të Nenit 17, paragrafit 1, nënparagrafëve 1.6, të Ligjit nr. 05/L-057 për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.08/L-138, dhe Nenit 8, paragrafit 1.5, të Statutit të FKGK;

Në mbledhjen e mbajtur më 25.09.2025, miratoi këtë:

POLITIKË TË MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL

KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Hyrje

1. Kjo Politikë paraqet vizionin dhe misionin e FKGK-së në lidhje me mjedisin, shoqërinë dhe kontributet në zhvillimin e qëndrueshëm. FKGK njeh rëndësinë e menaxhimit të riskut mjedisor dhe social dhe është e përkushtuar në identifikimin dhe adresimin e të gjitha risqeve të tilla që lidhen me aktivitetet e veta garantuese. Politika përcakton parimet dhe rregullat udhëzuese që duhet të jenë pjesë e praktikës së menaxhimit të riskut mjedisor dhe social të garancisë ku FKGK bartë pjesën më të madhe të riskut.
2. Objektivi i FKGK-së, përmes kësaj Politike, është:
 - 2.1. të plotësojë mandatin e tij institucional me përgjegjësi të plotë ndaj mjedisit dhe shoqërisë;
 - 2.2. të përcaktojë se si Institucionet e Regjistruara Financiare (këtu e tutje: IRF-të) që mbështeten nga FKGK do të vlerësojnë dhe menaxhojnë rreziqet dhe ndikimet mjedisore dhe sociale që lidhen me projektet që financon;
 - 2.3. të promovojë praktikat e mira të menaxhimit mjedisor dhe social për projektet e financuara nga IRF-të;
 - 2.4. të promovojë menaxhim të mirë dhe të shëndoshë të burimeve njerëzore brenda IRF-ve.
3. IRF-të do të kryejnë vlerësimet mjedisore në përputhje me legjislacionin mjedisor kombëtar dhe duke u bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare. Ky proces i vlerësimit kryhet: për të përcaktuar ndikimet e mundshme pozitive ose negative të projekteve të propozuara të kredimarrësve apo NMVM-ve; për të vlerësuar masat paraprake që duhet të ndërmerren për të shmangur, parandaluar, zbutur ose minimizuar ndikimet negative të cilat mund të dëmtojnë mjedisin; dhe, për mbikëqyrjen dhe inspektimin e zbatimit të projektit.

Neni 2 Qëllimi dhe fushëveprimi

4. Kjo Politikë ka për qëllim të krijojë një kornizë të qëndrueshme dhe e shëndetshme që vlerëson dhe mitigon riskun mjedisor dhe social të garancisë së kredisë në kuadër të aktiviteteve të FKGK-së.

1. Kjo Politikë rregullon marrëdhëniet në ndikimin indirekt të FKGK-së nëpërmjet shërbimit të garancisë së kredisë që i ofrohet kredimarrësit të kualifikuar.
2. Kjo Politikë definon dhe përcakton rregullat për:
 - 2.1. projektet e pranueshme dhe jo të pranueshme në aspektin mjedisor dhe social;
 - 2.2. shqyrtimin e riskut mjedisor dhe social;
 - 2.3. kategoritë e riskut mjedisor dhe social;
 - 2.4. kërkesat ligjore që duhet të plotësohen nga NMVM-të;
 - 2.5. mekanizmin e zgjidhjes së ankesave;
 - 2.6. monitorimin e IRF-ve dhe performancën e menaxhimit mjedisor dhe social të portofolit të garancisë të FKGK-së.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë Politikë kanë këto kuptime:
 - 1.1. **AMMK** – nënkupton Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës;
 - 1.2. **Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK)** – është entitet juridik i pavarur dhe autonom, i themeluar me Ligjin Nr. 05/L-057 për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore (tutje “Ligji për Themelimin e FKGK-së”), për të menaxhuar asetet e FKGK-së dhe për të ofruar Garanci Kreditore sipas dispozitave të Ligjit në fjalë, Statutit të FKGK-së, Politikave dhe Procedurave të brendshme të FKGK-së;
 - 1.3. **Garanci Kreditore** – nënkupton garancinë që jepet nga FKGK-ja për një institucion të regjistruar financiar, mbi një Kredi, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Themelimin e FKGK-së dhe Marrëveshjes së Garancisë;
 - 1.4. **IF** – nënkupton Institucion Financiar;
 - 1.5. **IRF** – nënkupton Institucion i Regjistruar Financiar;
 - 1.6. **Instrumentet Themelore të Organizatës Ndërkombëtare të Punës** - nënkupton instrumentet e Organizatës Ndërkombëtare të Punës, për punën e fëmijëve (konventat me numër C138 dhe C182), punën e detyruar (konventa me numër C029 dhe protokollin e saj i vitit 2014 me numër P029, dhe konventa me numër C105), diskriminimin (konventat me numër C100 dhe C111) dhe lirinë e shoqërimit dhe marrëveshjet kolektive (konventat me numër C087 dhe C098) shëndeti dhe siguria në punë (C155 dhe C187), që rrjedh nga Deklarata e Organizatës Ndërkombëtare të Punës mbi Parimet dhe të Drejtat Themelore në Punë, miratuar në 1998, e ndryshuar në 2022;
 - 1.7. **Standardet e Performancës së Korporatës Ndërkombëtare të Financave** – nënkupton Standardet e Performancës së Korporatës Ndërkombëtare Financiare mbi Qëndrueshmërinë Sociale dhe Mjedisore;
 - 1.8. **Kategoritë e Rrezikut Mjedisor dhe Social** – përfshin kategoritë A, B, dhe C, si dhe nënkategoritë B+ dhe B- siç përshkruhen në Nenin 11 të kësaj Politike¹;
 - 1.9. **Kredimarrës i Kualifikuar** – nënkupton një NMVM ose një fermë me një numër identifikimi, të kualifikuar për t'iu nënshtruar një garancie kreditore në përputhje me kriteret e përshtatshmërisë të parashikuara në marrëveshjen e garancisë;
 - 1.10. **Kredi e Kualifikuar** – nënkupton kreditë që plotësojnë kriteret e pranueshme të përcaktuara në këtë Politikë;

¹Kategoritë e rrezikut mjedisor dhe social emërtohen edhe si vijon: Kategoria e A rrezik i lartë mjedisor dhe social, kategori B+ rrezik i substancial mjedisor dhe social, kategoria B- rrezik i moderuar mjedisor dhe social dhe kategoria C rrezik i ulët mjedisor dhe social.

- 1.11. **KfW** – nënkupton Banka Gjermane për Zhvillim;
- 1.12. **MMPHI** – nënkupton Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- 1.13. **Marrëveshja e Garancisë** – nënkupton marrëveshjen e nënshkruar ndërmjet FKGK-së dhe IRF-së, e cila përcakton kushtet dhe afatet për garancinë kreditore;
- 1.14. **NMVM** – nënkupton një ndërmarrje mikro, të vogël apo të mesme të regjistruar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës që ka marrë numrin unik identifikues dhe që ka më pak se dyqind e pesëdhjetë (250) punonjës;
- 1.15. **NPP – nënkupton Njerëzit e Prekur nga Projekti** - individë ose grupe, duke përfshirë komunitetet lokale, të cilët preken ose ka gjasa të preken nga një projekt ose program për shkak të ndikimeve aktuale ose rreziqeve të mundshme për mjedisin e tyre fizik, shëndetin, sigurinë, praktikat kulturore, mirëqenien ose mjetet e punës;
- 1.16. **Organizata Ndërkombëtare e Punës** – nënkupton Agjencia trepalëshe e Kombeve të Bashkuara, e cila bashkon qeveritë, punëdhënësit dhe punëtorët e shteteve të saj anëtare në veprime të përbashkëta për të promovuar punën e denjë në mbarë botën;
- 1.17. **Performanca Mjedisore, Sociale, Shëndetësore dhe e Sigurisë** – nënkupton nivelin e përputhshmërisë së një projekti ose programi me planin e angazhimit mjedisor dhe social - EPAMS (nëse është e aplikueshme), instrumentet mjedisore dhe sociale dhe të gjitha kërkesat mjedisore dhe sociale;
- 1.18. **Politika e Menaxhimit Mjedor dhe Social (PMMS)** – nënkupton këtë Politikë të FKGK-së për Menaxhimin Mjedor dhe Social, përfshirë ndryshimet dhe plotësimet e saj;
- 1.19. **Sistemi i Menaxhimit Mjedor dhe Social (SMMS)** – nënkupton politikat, procedurat, mjetet, dhe kapacitetet, e brendshme, për të identifikuar dhe menaxhuar ekspozimin e Palës së Garantuar ndaj rreziqeve mjedisore dhe sociale të klientëve/investitorëve të tij, të miratuara në pajtueshmëri me PMMS-në e FKGK-së;
- 1.20. **Standardet e Performancës të Korporatës Ndërkombëtare të Financave** – përcaktojnë përgjegjësitë e klientëve të Korporatës Ndërkombëtare të Financave për menaxhimin e rreziqeve të tyre mjedisore dhe sociale;
- 1.21. **Udhëzimet MSS Grupit të Bankës Botërore** – nënkupton Udhëzimet e Grupit të Bankës Botërore për Mjedis, Shëndet dhe Siguri. Këto janë dokumente referencë teknike, me shembuj të përgjithshëm specifikë të industrisë të Praktikës së Mirë Ndërkombëtare të Industrisë (GIIP), në lidhje me menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë gjatë ndërtimit dhe funksionimit të projekteve ose programeve.

KAPITULLI II

ZBATIMI I KËRKESAVE TË POLITIKËS SË MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL

Neni 4

Autoriteti dhe Përgjegjësitë

1. Në procesin e përgatitjes dhe miratimit të PMMS dhe monitorimit dhe implementimit të saj në institucion dhe drejtuar palëve të treta, autoritetet dhe përgjegjësitë ndahen në përputhje me Ligjin për Themelimin e FKGK-së, Statutin e FKGK-së, dhe strukturën organizative të FKGK-së.
2. Bordi i Drejtorëve është përgjegjës për miratimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj Politike. Drejtori Menaxhues propozon këtë Politikë, ndryshimet dhe plotësimet e saj, për miratim të Bordi Drejtorëve, si dhe është përgjegjës për zbatimin e saj.
3. Specialisti Mjedisor, Social dhe Qeverisjes (tutje: SMSQ) është personi i caktuar përgjegjës për koordinimin dhe zbatimin e kësaj Politike në kuadër të operacioneve të brendshme të FKGK-së. SMSQ monitoron zbatimin e SMMS-së, organizon trajnime për stafin e FKGK-së dhe për IRF-të, si dhe paraqet rekomandime për ndryshimin apo plotësimin e PMMS-së sipas nevojës.
4. Njësia e Menaxhimit të Rrezikut dhe Njësia e Zhvillimit të Portofolit, gjatë procesit të vlerësimit të regjistrimit të IF-ve, pranimit të kredive nën garanci, dhe vlerësimit vjetor të IRF-ve, sigurohen që këto institucione janë në përputhje me kërkesat mjedisore, shoqërore, të shëndetit dhe sigurisë të përcaktuara në këtë Politikë. Gjithashtu, në baza të rregullta, njësitet përkatëse kujdesen t'ua rikujtojnë IRF-ve rëndësinë e respektimit të këtyre kërkesave, promovimit të vetëdijesimit të stafit dhe sigurimit të pajtueshmërisë së tyre me SMMS-në, Marrëveshjet e Garancisë dhe këtë Politikë.

Neni 5

Zbatimi i Sistemit të Menaxhimit Mjedisor dhe Social nga IF-të

1. IF-të që aplikojnë për t'u regjistruar në FKGK, ndër të tjera, duhet të përmbushin kërkesat vijuese:
 - 1.1. të kenë sistemin e menaxhimit mjedisor dhe social sipas standardeve të Korporatës Ndërkombëtare të Financave/Grupit të Bankës Botërore, dhe kërkesave nga kjo Politikë;
 - 1.2. të caktojnë një Zyrtar të Riskut që do të veprojë si Koordinator Mjedisor për zbatimin e SMMS.
2. IRF-të duhet të kenë ndërtuar praktika dhe krijuar kapacitete të brendshme në lidhje me zbatimin e SMMS-ve të tyre. IRF-të me SMMS-të funksionale në vend do të përdorin sistemet e tyre për shqyrtimin dhe menaxhimin projekteve.
3. IRF-të duhet të kenë caktuar një Zyrtar të Riskut që do të veprojë si një Koordinator Mjedisor i cili do të jetë përgjegjës për zbatimin e përditshëm të SMMS, përfshirë: (a)

procedurat, instrumentet dhe kërkesat M&S; (b) të sigurojë që burimet e duhura janë në dispozicion për menaxhim dhe trajnim në çështjet M&S; dhe, (c) të sigurojë që ekspertiza e duhur teknike, qoftë e brendshme apo mbështetje e ekspertëve të jashtëm, të jetë në dispozicion për të kryer kujdesin e duhur dhe për të menaxhuar rreziqet M&S të projekteve të IRF-së, përfshirë sigurimin e mbështetjes së zbatimit siç kërkohet.

4. IRF-të do të jenë përgjegjëse për kategorizimin e rrezikut mjedisor dhe social të projekteve, dhe për të siguruar që çdo projekt që është subjekt i garancisë përfshin një vlerësim të ndikimit të tij mjedisor dhe social të përshtatshëm për kategorinë dhe që projekti përputhet me rregullat kombëtare të mjedisit dhe sociale dhe kërkesat e tjera sipas kësaj Politike.
5. Projektet e kredimarrësve duhet t'i nënshtrohen një procesi të rishikimit mjedisor dhe social nga IRF-të.
6. Detyrimet dhe kushtet që rrjedhin nga kjo Politikë që ndërlidhen me IRF-të apo kredimarrësit e kualifikuar do të përfshihen në Marrëveshjet e Garancisë me IRF-të.

Neni 6

Përfshirja e Palëve të Interesit në Menaxhimin e Rreziqeve Mjedisore dhe Sociale

1. Në procesin e garantimit të kredive përfshihen tri (3) palë kryesore të interesit: (i) FKGK – i cili garanton portofolin e IRF-ve, (ii) IRF-të – përfituesit e garancive të FKGK-së, (iii) kredimarrësit e kualifikuar – NMVM-të.
2. Përgjegjësitë e palëve të lartpërmendura janë si vijon:
 - 2.1. FKGK është përgjegjëse për të zbatuar këtë Politikë dhe për të garantuar vetëm financimin e projekteve që përmbushin kriteret mjedisore dhe sociale;
 - 2.2. IRF-të janë përgjegjëse për të zbatuar kërkesat e PMMS, për të përdorur garancitë e FKGK-së vetëm për projekte të shëndosha mjedisore siç përcaktohet në këtë Politikë, dhe për të kërkuar nga kredimarrësit e tyre të jenë në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga legjislacioni i aplikueshëm dhe kërkesat që burojnë nga marrëveshjet e garancisë lidhur me shëndetin, sigurinë dhe mjedisin;
 - 2.3. Kredimarrësit e Kualifikuar janë përgjegjës për të qenë në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga marrëveshjet e tyre të kredisë dhe legjislacioni i aplikueshëm në fuqi lidhur me sigurinë dhe shëndetin në punë dhe mjedisin.

Neni 7

Legjislacioni i Aplikueshëm Mjedisor, Social, i Shëndetit dhe i Sigurisë

1. MMPHI dhe AMMK janë dy institucione kryesore qeveritare që përpilojnë, zbatojnë dhe mbikëqyrin zbatimin e legjislacionit dhe rregulloreve mjedisore në Kosovë.
2. MMPHI është një organ qendror ekzekutiv i ngarkuar me krijimin dhe zbatimin e legjislacionit të përgjithshëm të menaxhimit në fushën e mjedisit, ujit, planifikimit hapësinor të banesave dhe ndërtimit.
3. AMMK është një institucion qeveritar i cili, nëpërmjet monitorimit të integruar mjedisor, sistemit efikas të informacionit mjedisor, dhe raportimit të vazhdueshëm mbi gjendjen e

mjedisit, angazhohet për ruajtjen e cilësisë së ajrit, ujit, tokës dhe biodiversitetit, promovimin e përdorimit të burimeve të ripërtërishme të energjisë dhe përdorimin e burimeve natyrore në mënyrë të qëndrueshme.

4. Qeveritë lokale – komunat – e kanë kompetencën për lëshimin e Lejes Mjedisore Komunale për projekte dhe aktivitetet që janë subjekt i Lejeve të tilla të listuara në Shtojcën e Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2017 të MMPHI-së, si dhe projektet dhe aktivitetet që e kanë kaluar fazën e përzgjedhjes në MMPHI dhe janë vlerësuar të jenë subjekt i Lejes Mjedisore Komunale dhe jo i Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor. Nëse nuk kërkohet një raport Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor, komuna relevante vlerëson projektin sipas kërkesave të lejes komunale dhe mund të fillojë procedurë për lëshimin e Lejes Mjedisore Komunale.
5. Gjatë procesit të vlerësimit të kredive të garantuara, FKGK bazohet në ligjet e zbatueshme të listuara më poshtë:
 - 5.1. Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, përfshirë ndryshimet dhe plotësimet e tij;
 - 5.2. Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis;
 - 5.3. Ligji i Punës, përfshirë ndryshimet dhe plotësimet e tij;
 - 5.4. Ligji për Mbrojtjen e Natyrës, përfshirë ndryshimet dhe plotësimet e tij;
 - 5.5. Ligji për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit;
 - 5.6. Ligji për Ndërtim, përfshirë ndryshimet dhe plotësimet e tij;
 - 5.7. Ligji për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, përfshirë ndryshimet dhe plotësimet e tij;
 - 5.8. Ligji për Mbeturinat, përfshirë ndryshimet dhe plotësimet e tij;
 - 5.9. Ligji për Mbrojtjen nga Zhurma, përfshirë ndryshimet dhe plotësimet e tij;
 - 5.10. Ligji për Trashëgiminë Kulturore;
 - 5.11. Ligji për Ujërat e Kosovës, përfshirë ndryshimet dhe plotësimet e tij;
 - 5.12. Ligjet tjera të aplikueshme për qëllim të vlerësimit të kredive për garanci kreditore.

Neni 8

Standardet e Zbatueshme Ndërkombëtare Mjedisore dhe Sociale

1. Për zbatimin e kësaj Politike, FKGK obligohet të zbatojë standardet ndërkombëtare mjedisore dhe sociale të listuara më poshtë:
 - 1.1. Standardet e Performancës së Korporatës Ndërkombëtare të Financave:
 - 1.1.1. Standardi i Performancës 1: Vlerësimi dhe Menaxhimi i Risqeve dhe Ndikimeve Mjedisore dhe Sociale;
 - 1.1.2. Standardi i Performancës 2: Puna dhe Kushtet e Punës;
 - 1.1.3. Standardi i Performancës 3: Efiçienca e Burimeve dhe Parandalimi i Ndotjes;
 - 1.1.4. Standardi i Performancës 4: Shëndeti dhe Siguria e Komunitetit.
 - 1.2. Direktivën për Qëndrueshmëri të KfW-së;
 - 1.3. Udhëzimet e Grupit të Bankës Botërore për Shëndetin dhe Sigurinë Mjedisore dhe udhëzimet e zbatueshme për sektorin specifik;
 - 1.4. Konventat Themelore të Punës dhe Instrumentet Themelore të Organizatës Ndërkombëtare të Punës;
 - 1.5. Shënimi i Interpretimit të Korporatës Ndërkombëtare të Financave mbi Ndërmjetësuesit Financiarë (IF-të);
 - 1.6. Standardet Mjedisore dhe Sociale të Bankës Evropiane për Investime dhe Fondit Evropian të Investimeve;
 - 1.7. Klasifikimin Statistikor të Veprimtarive Ekonomike në Komunitetin Evropian (kodet NACE).

Neni 9

Standarde të tjera Mjedisore dhe Sociale të rëndësishme, por jo të zbatueshme për FKGK

1. Standardet tjera të rëndësishme ndërkombëtare mjedisore dhe sociale, që nuk janë të zbatueshme për FKGK-në, përfshijnë:
 - 1.1. Standardi i Performancës 5: Blerja e Tokës dhe Zhvendosja e Pavullnetshme;
 - 1.2. Standardi i Performancës 6: Ruajtja e Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Burimeve Natyrore të Gjalla;
 - 1.3. Standardi i Performancës 7: Popujt Vendas;
 - 1.4. Standardi i Performancës 8: Trashëgimia Kulturore;
 - 1.5. Parimet Themelore të OKB-së dhe Udhëzimet mbi Dëbimet dhe Zhvendosjet e Bazuara në Zhvillim;
 - 1.6. Komisioni Botëror i Digave (WCB) (për projekte të mëdha të digave);
 - 1.7. Standardet mjedisore dhe sociale të Bankës Botërore 10.

Neni 10

Sektorët e ndaluar, kufizuar dhe qëllimet e kredisë

1. Kjo Politikë është e bazuar në listën e përjashtimit të institucioneve partnere të FKGK-së.
2. Kjo Politikë përcakton sektorët e ndaluar dhe të kufizuar si vijon:
 - 2.1. Puna e detyruar² ose puna e fëmijëve³;
 - 2.2. Aktivitetet ose materialet që konsiderohen të paligjshme sipas ligjeve ose rregulloreve të vendit pritës ose konventave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, ose që i nënshtrohen fazës ose ndalimeve ndërkombëtare, të tilla si:
 - 2.1.1. substancat që ndikojnë në tkurrjen e mbështjellësit të ozonit, PCB-të (Bifenilet e Poliklorinuara) dhe produkte të tjera specifike të rrezikshme, pesticide/herbicide ose kimikate;
 - 2.1.2. kafshë të egra ose produkte të rregulluara sipas Konventës mbi Tregtinë Ndërkombëtare të Specieve të Rrezikuara ose të Faunës dhe Florës së Egër (CITES); ose
 - 2.1.3. metodat e paqëndrueshme të peshkimit (të tilla si peshkimi me shpërthim dhe peshkimi neto në mjedisin detar duke përdorur rrjeta që tejkalojnë 2.5 km gjatësi).
 - 2.3. Tregtinë ndërkufitare të mbeturinave dhe produkteve të mbeturinave, përveç nëse është në pajtim me Konventën e Bazelit dhe rregulloret themelore;
 - 2.4. Shkatërrimin e zonave me Vlera të Larta Ruajtjeje⁴;

² Puna e detyruar nënkupton të gjitha punët ose shërbimet që nuk kryhen vullnetarisht, që nxirren nga individi nën kërcënimin e forcës ose ndëshkimit, siç përcaktohet me konventat e ILO-së.

³ Puna e dëmshme e fëmijëve nënkupton punësimin e fëmijëve që është ekonomikisht shfrytëzues, ose ka të ngjarë të jetë i rrezikshëm ose të ndërhyjë në edukimin e fëmijës, ose të jetë i dëmshëm për shëndetin e fëmijës, ose zhvillimin fizik, mendor, moral ose social. Përveç kësaj, çdo punë që kryhet nga një person që ende nuk ka mbushur moshën 15 vjeç konsiderohet të jetë e dëmshme, përveç nëse legjislativi vendor specifikon frekuentimin e detyrueshëm të shkollës ose moshën minimale për të punuar të jetë më e lartë; në raste të tilla do të zbatohet moshën më e lartë për përcaktimin e punës së dëmshme të fëmijëve.

⁴ Shkatërrimi nënkupton (1) eliminimin ose zvogëlimin e ndjeshëm të integritetit të një zone të shkatëruar nga një ndryshim madhor afatgjatë në shfrytëzimin e tokës ose ujit ose (2) modifikimin e habitatit ashtu që humb aftësia e

- 2.5. Materialet radioaktive⁵ dhe fibrat e pakufizuara të asbestit;
- 2.6. Pornografinë dhe/ose prostitucionin;
- 2.7. Lojërat e fatit, kazinotë dhe ndërmarrjet ekuivalente apo hotelet që ofrojnë shërbime të tilla;
- 2.8. Municioni dhe armët, pajisjet ose infrastruktura ushtarake/police ose qendrat korrektuese;
- 2.9. Mediat raciste dhe/ose anti-demokratike;
- 2.10. Aktivitetet e ndaluara sipas kodeve NACE të përcaktuara në Shtojcën II të kësaj Politike;
- 2.11. Kufizimet e Sektorit të TI-së: kërkime, zhvillime ose aplikime teknike që kanë të bëjnë me programet ose zgjidhjet elektronike të të dhënave, të cilat synojnë në mënyrë specifike/ose që përfshijnë:
 - 2.11.1. duke mbështetur çdo aktivitet të përfshirë në Sektorët e Kufizuar të referuar nën 2.2. dhe 2.8. (përfshirë) në këtë Nen;
 - 2.11.2. bixhozit në internet dhe kazinove online;
 - 2.11.3. kanë për qëllim të mundësojnë në mënyrë të paligjshme;
 - 2.11.4. hyjnë në rrjetet elektronike të të dhënave; ose
 - 2.11.5. shkarkimin e të dhënave elektronike;
- 2.12. Kufizimet e sektorit të shkencës së jetës: kur ofrohet mbështetje për financimin e kërkimit, zhvillimit ose aplikacioneve teknike në lidhje me:
 - 2.12.1. klonimet njerëzore për qëllime kërkimore ose terapeutike;
 - 2.12.2. organizmat gjenetiksht të modifikuar ("OGJM"); dhe
 - 2.12.3. kafshë të gjalla për qëllime shkencore dhe eksperimentale, duke përfshirë edhe mbarështimin e këtyre kafshëve.
- 2.13. Termocentralet bërthamore (përveç masave që zvogëlojnë risqet mjedisore të aseteve ekzistuese) dhe minierat me uranium si një burim thelbësor i nxjerrjes;
- 2.14. Gurëthyesit;
- 2.15. Zbulimi, kërkimi dhe nxjerrja e qymyrit;
- 2.16. Mjetet e transportit me bazë tokësore dhe infrastruktura përkatëse e përdorur në thelb për qymyr;
- 2.17. Termocentralet, stacionet e ngrohjes dhe pajisjet e kogjenerimit me qymyr, si dhe linjat shoqëruese⁶;
- 2.18. Kërkimi, eksplorimi dhe nxjerrja jo-konvencionale e naftës nga argjila, rërë katrani ose rërë vaji;
- 2.19. Blerja e pajisjeve të prerjes së pyjeve për t'u përdorur në pyjet natyrore tropikale ose pyjet me vlerë të lartë natyrore në të gjitha rajonet, dhe aktivitetet që çojnë në prerje të pastra dhe/ose degradim të pyjeve natyrore tropikale ose pyjeve me vlerë të lartë natyrore;

zonës për të ruajtur rolin e saj. Vlerat e Larta të Ruajtjes (HCV) përcaktohen si habitate natyrore ku këto vlera konsiderohen të rëndësishme ose me rëndësi kritike (Shih <http://ëëë.hcvnetëork.org>).

⁵ Kjo nuk vlen për blerjen e pajisjeve mjekësore, pajisjeve të kontrollit të cilësisë (matjes) ose ndonjë pajisjeje tjetër ku burimi radioaktiv kuptohet të jetë i papërfillshëm dhe/ose i mbrojtur në mënyrë adekuate.

⁶ Investimet në rrjetet e transmetimit të energjisë me furnizim të rëndësishëm të energjisë me bazë qymyri do të ndiqen vetëm në vende dhe rajone me një politikë ose strategji kombëtare ambicioze për mbrojtjen e klimës (NDC), ose ku investimet synojnë të zvogëlojnë pjesën e energjisë me bazë qymyri në rrjetin përkatës.

- 2.20. Plantacionet e reja të vajit të palmës;
- 2.21. Në rast se ndonjë prej produkteve të mëposhtme përbën një pjesë të konsiderueshme⁷ të aktiviteteve të financuara primare të një projekti:
 - 2.21.1. prodhimi dhe tregtia e pijeve alkoolike (përveç birrës dhe verës);
 - 2.21.2. prodhimi dhe tregtia e duhanit;
- 2.22. Sektorët intensiv të karbonit të lejuar sipas kodeve NACE⁸ të përcaktuara në Shtojcën I të kësaj Politike;
- 2.23. Dëbime me forcë⁹.

Neni 11

Kategorizimi i Risqeve Mjedisore dhe Sociale

1. Në varësi të llojit, vendndodhjes, ndjeshmërisë, shkallës së projektit, dhe natyrës dhe madhësisë së ndikimeve të tij të mundshme mjedisore dhe sociale, investimi përfundimtar i NMVM-ve mund të klasifikohet në një nga tre kategoritë: A, B dhe C.
2. Kreditë për aktivitete që bien në Kategorinë A nuk do të garantohen nga FKGK, pasi që ato mund të kenë ndikime të padëshirueshme, të konsiderueshme, të larmishme dhe/ose afatgjata në shëndetin e njeriut dhe mjedisin. Kreditë për aktivitetet që hyjnë në kategoritë B dhe C, në anë tjetër, do të garantohen nga FKGK në përputhje me këtë Politikë dhe aktet e brendshme të saj.
3. **Kategoria A:** aktivitetet që bëjnë pjesë në këtë kategori janë ato projekte ose programe që potencialisht sjellin ndikime ose rreziqe të rëndësishme negative që janë të ndryshme, të pakthyeshme ose të paprecedentë. Për shembull, ato mund të prekin një zonë më të gjerë se sa thjesht objektin në ndërtim, vendndodhjen ose zonën e projektit ose mund të pritet të kenë efekte të rëndësishme negative në zonat e mbrojtura, biodiversitetin, pasuritë kulturore ose materiale ose grupet indigjene. Ato gjithashtu mund të shoqërohen me burime intensive, me rreziqe të larta për shëndetin e njeriut ose që kërkojnë zhvendosje.
4. **Kategoria B:** aktivitetet që hyjnë në këtë kategori janë ato projekte që ndikimet e tyre të mundshme të pafavorshme mjedisore mbi njerëzit ose mjedisin janë më pak të dëmshme se ato të projekteve të Kategorisë A. Në mënyrë tipike, ndikimi dhe risqet e mundshme të aktiviteteve të kategorisë B janë të kufizuara në zonat lokale, në shumicën e rasteve janë të kthyeshme përmes masave të përshtatshme. Kategoria B përfshin projekte të tilla si azhurnimet, punët civile, ndërtimet, si dhe rindërtimin, rehabilitimin ose përshtatjen e ndërtesave ekzistuese. Kjo kategori ndahet në nënkategoritë B+ dhe B-:
 - 4.1. **B+:** përfshin projekte për ndërtim që janë të përfshira në Shtojcën II të Ligjit të Kosovës për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (Shtojca VI e kësaj Politike) që nuk kërkojnë Vlerësim të plotë të Ndikimit në Mjedis nga MMPHI. Përveç kredive që

⁷ Per NMVM-të, e konsiderueshme do të thotë me shume se cilido nga njeri prej këto dy kritereve: a) 10% e bilancit të tyre të konsoliduar të gjendjes (aseteve totale) ose b) 10% të të hyrave nga shitjet. Për institucionet financiare dhe fondet e investimeve, "e konsiderueshme" do të thotë më shumë se 10% e vëllimit të tyre të portofolit bazë.

⁸ Pjesëmarrja e këtyre aktiviteteve nuk duhet të tejkalon 10% në portofolin aktive të IRF-së brenda FKGK-së.

⁹ "Dëbimet me forcë i referohen veprimeve dhe/ose mosveprimeve që përfshijnë zhvendosjen e detyruar, të përhershme ose të përkohshme të pavullnetshme të individëve, grupeve dhe komuniteteve nga shtëpitë dhe/ose tokat dhe burimet e pronës së përbashkët që ata i zënë ose nga të cilat varen, duke eliminuar ose kufizuar kështu aftësinë e një individit, grupi ose komuniteti për të qëndruar ose punuar në një banesë, vendbanim ose vendndodhje të caktuar, pa sigurimin dhe aksesin në forma të përshtatshme të mbrojtjes ligjore ose të tjera."

kualifikohen në Dritaren e Gjellbër - GROW, rastet që kërkojnë Vlerësim të Ndikimit në Mjedis që bien në këtë kategori nuk do të garantohen nga FKGK.

- 4.2. **B-**: përfshin punët e vogla civile, ndërtime të vogla (anekset e ndërtesave), renovim i jashtëm, rindërtim, rehabilitim ose adaptim i ndërtesës ekzistuese.
5. **Kategoria C**: aktivitetet kategorizohen në këtë kategori nëse ka të ngjarë të kenë ndikime minimale ose aspak të dëmshme në mjedis dhe për këtë arsye nuk kërkohet një Vlerësim Mjedisor. Kategoria C mund të përfshijë projekte të tilla si investime në asete fikse, kapital qarkullues, blerje të pasurive të paluajtshme, renovime (në hapësira të brendshme), blerje toke dhe ndërtesash. Përtej shqyrtimit fillestar, nuk kërkohet asnjë veprim i mëtejshëm i vlerësimeve mjedisore për një projekt të Kategorisë C.

Neni 12 Dokumentacioni për Vlerësim Mjedisor

1. Aplikuesi përgatitë një koncept fillestar të projektit. Pas diskutimit me IRF-në, në të cilin IRF njofton aplikuesin për kërkesat e vlerësimit mjedisor, IRF shpërndan Formularin e Vlerësimit të Riskut Mjedisor dhe Social (Shtojca III). Aplikuesi siguron informacionin e kërkuar dhe dorëzon Formularin e Vlerësimit të Riskut Mjedisor dhe Social dhe dokumentacionin tjetër të kërkuar në IRF. Aplikuesi ka përgjegjësinë të fillojë diskutime me MMPHI-në ose Komunën përkatëse në mënyrë që të përmbushë çdo kërkesë të nivelit lokal apo qendror të rishikimit të mjedisit (të tilla si shqyrtimi mbi procedurën e Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe/ose miratimet apo lejet e tjera zyrtare). Aplikuesi ka përgjegjësi të pajiset me lejet dhe licencat përkatëse që kërkohen nga ligjet në fuqi, në mënyrë që të lehtësojë procesin me MMPHI-në ose Komunën përkatëse. Në kohën kur aplikuesi kontakton me IRF-në, të gjitha lejet dhe opinionet/pëlqimet/miratimet duhet të merren nga aplikuesi. Këto kërkesa konsiderohen të ndara, por paralele, me ato të paraqitura këtu, dhe plotësimi i tyre është përgjegjësi e aplikuesit. Aplikuesi është përgjegjës për vlefshmërinë dhe vërtetësinë e informacionit të dhënë në Formularin e Vlerësimit të Riskut Mjedisor dhe Social dhe dokumenteve të tjera.
2. Bazuar në Formularin e Vlerësimit të Riskut Mjedisor dhe Social, IRF kategorizon projektin si A ose ndryshe jo i pranueshëm, B+, B-, C, si vijon:
 - 2.1. për projektet e kategorisë B+, IRF-të plotësojnë Formularin e Vlerësimit të Riskut Mjedisor dhe Social. IRF informon aplikuesin për (i) kategorinë e riskut Mjedisor dhe Social, (ii) procesin dhe raportet e kërkuara. Diskutimi publik për projektet B+ do të bëhet sipas legjislacionit në fuqi dhe kërkesave të institucioneve partnere të FKGK-së;
 - 2.2. për projektet e kategorisë B-, IRF-të plotësojnë Formularin e Vlerësimit të Riskut Mjedisor dhe Social. Për këtë lloj të kategorisë, miratimi nga FKGK nuk është i nevojshëm. SMSQ do të ofrojë ndihmë kur kërkohet;
 - 2.3. për projektet e kategorisë C, nuk kërkohen veprime të tjera përveç ndjekjes së procedurave të brendshme të menaxhimit mjedisor nga IRF.
3. Kur IRF është e kënaqur me dokumentacionin mjedisor të ofruar nga aplikuesi, IRF miraton aplikimin, shpërndan kredinë dhe kërkon garancionin. Aplikuesi zbaton masat zbutëse dhe monitoruese në Planin e Veprimit Korrektues. IRF-të do të kryejnë mbikëqyrje dhe do të propozojnë veprime korrigjuese nëse është e nevojshme. Të paktën tre (3) Format e para të Vlerësimit të Riskut Mjedisor dhe Social të secilës IRF që regjistrohet për herë të parë në FKGK do të jenë objekt i rishikimit dhe aprovimit të FKGK-së.

4. Për të gjitha projektet e kategorisë B, në rast të mospërputhjeve, do të raportohet në Raportin e Auditimit Mjedisor dhe do t'i dorëzohet FKGK-së. IRF-të duhet të mbajnë regjistra të Formularëve të Vlerësimit të Riskut Mjedisor dhe Social, dhe dokumenteve përkatëse të lidhura (të tilla si regjistrat e mbetjeve, ankesat). Krahas mbikëqyrjes, Auditimet Mjedisore do të vlerësohen kundrejt këtyre dokumenteve.

Neni 13 Mekanizmi i Ankesave

1. FKGK ka krijuar Mekanizmin për Zgjidhjen e Ankesave (MZA). Mekanizmi është i hapur për publikun e gjerë, dhe në veçanti për personat e prekur nga projekti, dhe fuqinë punëtore të angazhuar në implementimin e projektit. Ueb faqja e FKGK-së ka informacionin e kontaktit të SMSQ të cilit mund t'i paraqitet ankesa, si dhe përshkrimin e procesit të MZA-së.
2. Ankesat do të adresohen nga Komiteti i Ankesave i përbërë nga Drejtori Menaxhues, Menaxheri i Lartë Ligjor dhe i Pajtueshmërisë dhe SMSQ.
3. Komiteti i Ankesave do të marrë një Vendim ndaj Ankesës, nëse përmbushen kriteret vijuese:
 - 3.1. ankesa ka të bëjë me ndonjë nga aktivitetet e garancisë;
 - 3.2. përmban një sasi të mjaftueshme të detajeve për të treguar një veprim negativ që ka ndodhur ose ka të ngjarë të ndodhë, duke ndikuar në mirëqenien individuale ose kolektive ose duke paraqitur risk për mjedisin.
4. Në rastin kur kriteri i dytë i përcaktuar në nënparagrafin 3.2 të këtij neni nuk është përmbushur plotësisht, SMSQ do të bëjë kërkime të mëtejshme (me ose pa kontaktuar ankuesin), do t'i ndërmarrë masat korrigjuese, dhe, më pas, do t'i japë përgjigje ankuesit. Nëse ankesa është anonime, përgjigja do të jepet në faqen e internetit të FKGK-së.
5. SMSQ raporton, çdo muaj, te Menaxhmenti i FKGK-së dhe te donatorët apo/dhe partnerët financiar në lidhje me ankesat e marra gjatë vitit dhe cilat masa janë marrë ose planifikohen të ndërmerren si përgjigje ndaj tyre.
6. FKGK, përmes marrëveshjeve të garancisë, do të kërkojë nga IRF të zhvillojë dhe zbatojë një Mekanizëm të Ankesave. Mekanizmi i Ankesave duhet të jetë i qasshëm për publikun e gjerë dhe në veçanti për individët e prekur nga Projekti i financuar përmes kredive të garantuara, si dhe për fuqinë punëtore të angazhuar në zbatimin e projekteve të financuara në përputhje me kërkesat e IFC PS 1.

Neni 14 Monitorimi dhe Raportimi

1. Pasi që kredia të disbursohet dhe të pranohet nën garanci, investimi – *qëllimi i kredisë së NMVM-së* – hyn në fazën e zbatimit, kurse puna mjedisore kalon në një fazë të re.
2. Gjatë zbatimit të investimeve, NMVM-të janë përgjegjëse për kryerjen e aktiviteteve të tyre të përditshme dhe zbatimin e masave zbutëse në përputhje me kërkesat e përcaktuara në rregulloren kombëtare të mjedisit/sociale dhe praktikatat e mira të industrisë.
3. IRF-të pritet të monitorojnë kredimarrësit e tyre sipas politikave të brendshme dhe t'i raportojnë FKGK-së për performancën mjedisore dhe sociale, shëndetësore dhe të

sigurisë, të kredimarrësve të tyre nëse ndodhë një mospajtueshmëri apo në rast të incidenteve serioze mjedisore, sociale, të shëndetit dhe sigurisë.

4. FKGK përmes marrëveshjeve të garancisë do të kërkojë nga IRF-të të raportojnë lidhur me performancën mjedisore dhe sociale të kredive dhe zhvillimin e SMMS, ankesave dhe incidenteve të pranuar, të paktën një herë në vit dhe menjëherë në rast të incidenteve serioze mjedisore, sociale, shëndetësore, dhe të sigurisë.
5. FKGK, në baza të rregullta mujore, monitoron zhvillimin e portofolit të garancive të përgjithshme në aspektin e kategorizimit të mjedisit, të cilat duhet t'i prezantohen menaxhmentit. Monitorimi do të përfshijë:
 - 5.1. kategorizimin e portofolit sipas IRF-ve;
 - 5.2. cilësinë e portofolit të kredisë sipas kategorizimit të rrezikut mjedisor dhe social;
 - 5.3. cilësinë mjedisore dhe sociale të portofolit sipas destinimit;
 - 5.4. cilësinë mjedisore dhe sociale të portofolit sipas sektorëve ekonomik, ankesat dhe incidentet e mundshme, përfshirë çdo shqetësim të ngritur nga komuniteti, përfituesit, ose vetë IRF-të;
 - 5.5. monitorimin e projekteve të kategorisë B+, përfshirë: zbatimin e masave mitiguese të përcaktuara në formularë të vlerësimit të ndikimit mjedisor dhe social;
 - 5.6. verifikimin në terren se IRF-të dhe kredimarrësit e kualifikuar janë në përputhje me Politikën e FKGK-së, duke përfshirë në veçanti masat dhe procedurat mjedisore dhe sociale. SMSQ, në baza të rregullta, përmes mostrave të përzgjedhura bën vlerësimin e pajtueshmërisë me PMMS dhe kriteret e kategorizimit të riskut mjedisor dhe social në pajtueshmëri me këtë Politikë.
6. Qëllimi i monitorimit është përcaktimi i shpërndarjes së portofolit dhe përqendrimi i riskut Mjedisor dhe Social.
7. FKGK do të informojë Bordin e Drejtorëve dhe donatorët dhe/apo partnerët e tij financiar për zhvillimin e portofolit dhe çdo mospërputhje përmes raportimit të përgjithshëm.
8. Standardet e raportimit që FKGK ka përcaktuar sigurojnë që informatat e duhura mbi riskun mjedisor dhe social janë të disponueshme për të gjitha nivelet e organizatës dhe se kërkesat e raportimit të brendshëm dhe të jashtëm mund të përmbushen në kohë dhe raportet janë me cilësi të lartë.

KAPITULLI III DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 15 Implementimi i Politikës

1. Kjo Politikë ka për qëllim të sigurojë drejtimin e rregullt të FKGK-së dhe për të vendosur rregullat e brendshme të sjelljes dhe standardet profesionale të kërkuara për t'u përmbushur nga punonjësit dhe menaxhmenti i FKGK-së.
2. FKGK, në ofrimin e shërbimeve të tij, do të jetë në përputhje të plotë me këtë Politikë. Në rast se ekziston një konflikt ndërmjet kësaj Politike dhe Ligjit për Themelimin e FKGK-së, Ligji do të mbizotërojë.
3. Drejtori Menaxhues nxjerr vendimin që rregullon zbatimin e masave për efikasitet të energjisë dhe optimizimin brenda FKGK-së.

Neni 16 Ndryshimet në këtë Politikë

1. Kjo Politikë do të shqyrtohet nga Bordi i Drejtorëve dhe mund të ndryshohet kurdo që Bordi e shoh të arsyeshme, në rast të ndryshimit të rrethanave ose për të qenë në përputhje me ligjet në fuqi.
2. Për çdo ndryshim në këtë Politikë do të kërkohet pëlqimi i institucioneve partnere përkatëse, në përputhje me marrëveshjet në fuqi.

Neni 17 Dispozitat shfuqizuese

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Politike, shfuqizohet Politika e Menaxhimit Mjedisor dhe Social e datës 28.04.2023.
2. Të gjitha vendimet, politikat dhe dokumentet e tjera të aprovuara nga Bordi i Drejtorëve ose Drejtori Menaxhues bazuar në Politikën e mëparshme do të vazhdojnë të qëndrojnë në fuqi derisa të mos shfuqizohen ose zëvendësohen me vendime dhe dokumente tjera bazuar në këtë Politikë.

Neni 18 Pajtueshmëria dhe Sanksionet

Punonjësit e FKGK-së janë individualisht përgjegjës për respektimin e kësaj Politike. Shkeljet e kësaj Politike dhe rregullat dhe ndalimet e lartpërmendura mund t'i nënshtrojnë punonjësit ndaj masave disiplinore.

Neni 19 **Shtojcat**

1. Kjo Politikë përfshin shtojcat e mëposhtme:

- 1.1. Shtojca I - Sektorët intensivë të karbonit të listuara sipas kodeve NACE;
- 1.2. Shtojca II- Sektorët e ndaluar sipas kodeve NACE;
- 1.3. Shtojca III - Formulari i Vlerësimit të Riskut Mjedisor dhe Social;
- 1.4. Shtojca IV - Rrjedha e Procesit të Miratimit të Kredisë;
- 1.5. Shtojca V - Projektet e renditura në Shtojcën I të Ligjit të Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor që kërkon një Vlerësim të Ndikimit Mjedisor;
- 1.6. Shtojca VI - Projektet e renditura në Shtojcën II të Ligjit kombëtar të Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor;
- 1.7. Shtojca VII - Lista e aktiviteteve që i nënshtrohen Lejes Mjedisore Komunale.

Neni 20 **Hyrja në fuqi**

Kjo Politikë hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Drejtorëve.

25.09.2025
Agan Azemi
Kryesues i Bordit të Drejtorëve

Shtojca I
Sektorët intensivë të karbonit të listuar sipas kodeve NACE

1411	Prodhimi i veshjeve të lëkurës
1711	Prodhimi i brumit të letrës
1712	Prodhimi i letrës dhe kartonit
2352	Prodhimi i gëlqeres dhe llaçit
2451	Hedhja (fonderia) e hekurit
4612	Aktivitetet e ndërmjetësimit për shitjen e karburantit, mineraleve, metaleve dhe kimikateve industriale
4671	Tregtia me shumicë e lëndëve djegëse të ngurta, të lëngëta ose të gazta dhe produkteve të lidhur me to
4730	Tregtia me pakicë e karburantit automobilistik në dyqane të specializuara
4941	Transporti i mallrave me rrugë (përveç automjeteve hibride ose elektrike)

Shtojca II

Aktivitetet e ndaluar sipas kodeve NACE

0115	Kultivimi i duhanit
0220	Prerja e drunjve
0510	Nxjerrja e qymyrit të fortë
0520	Nxjerrja e linjtit
0710	Nxjerrja e xeheve të hekurit
0721	Nxjerrja e xeheve të uraniumit dhe toriumit
0729	Nxjerrja e xeheve të tjera jo-hekuri
0811	Nxjerrja e gurit dekorativ dhe të ndërtimit, gurit gëlqeror, gjipsit, shkumësit dhe rrasave
0899	Aktivitetet e tjera nxjerrëse dhe gurëthyes p.k.t.
1200	Prodhimi i produkteve të duhanit
1910	Prodhimi i produkteve të furrës së koksit
2012	Prodhimi i ngjyrave dhe pigmenteve
2013	Prodhimi i produkteve të tjera kimike me bazë inorganike
2014	Prodhimi i produkteve të tjera kimike me bazë organike
2015	Prodhimi i plehrave kimike dhe komponimeve të azotit
2016	Prodhimi i plastikës në format primare
2017	Prodhimi i gomës sintetike në format primare
2020	Prodhimi i pesticideve dhe produkteve të tjera agrokimike
2351	Prodhimi i çimentos
2410	Prodhimi i hekurit dhe çelikut bazë, si dhe i ferrolegurave
2442	Prodhimi i aluminit
2443	Prodhimi i plumbit, zinkut dhe kallajit
2444	Prodhimi i bakrit
2445	Prodhimi i metaleve të tjera jo-ferrike
2446	Përpunimi i lëndës djegëse nukleare
2452	Fonderia e çelikut
2454	Fonderia e metaleve të tjera jo-ferrike
3812	Grumbullimi i mbeturinave të rrezikshme
3822	Trajtimi dhe asgjësimi i mbeturinave të rrezikshme
4635	Tregtia me shumicë e produkteve të duhanit
4726	Tregtia me pakicë e produkteve të duhanit në dyqane të specializuar

Shtojca III
Formulari i Vlerësimit të Riskut Mjedisor dhe Social

Emri i bankës:		Data e vizitës në terren:	___/___/___	Emri dhe pozita e stafit të bankës:	
Emri i biznesit/klientit:		Aktiviteti:		Sektori:	
Emri i aksionarit të biznesit:		Numri i telefonit të kontaktit:		Adresa e biznesit:	
Shuma e kërkuar për financim:		Lloji i investimit:		Përshkrimi shkurtër i Planit të Investimeve:	
Kategoria Mjedisore dhe Sociale: (B+, B-, C)		Lista përjashtuese:		Çështjet Specifike Mjedisore dhe Sociale (Ndikimet gjatë zbatimit të investimit):	

VLERËSIMI I KËRKESAT E ZBATUESHME		PO	J O	N / A	INFORMACION SHTESË	KOMENTE
Aspekti	Informacioni kërkuar				(Ju lutemi jepni informacione shtesë për të mbështetur të gjitha përgjigjet)	
Ligjet Kombëtare:	A përputhet aktiviteti me kërkesat rregullatore kombëtare?					
	Në përputhje me aktivitetin e biznesit dhe kërkesat rregullatore, a kërkohet ndonjë leje/licencë specifike mjedisore? Nëse PO, në informacionin shtesë, renditni					

	emrat e lejeve/licencave të nevojshme, datat e skadimit të tyre dhe provat e posedimit të tyre.					
Vlerësimi i Rreziqeve dhe Ndikimeve Mjedisore dhe Sociale të Biznesit të Klientit						
1. Vlerësimi dhe Menaxhimi i Rreziqeve dhe Ndikimeve Mjedisore dhe Sociale	1.1. A ka kompania një sistem për menaxhimin e rreziqeve mjedisore dhe sociale të aktiviteteve të saj të biznesit? Nëse po, kush është personi përgjegjës?					
	1.2 Sa është numri i punonjësve në kompani?					
	1.3 A është kompania në përputhje me ligjet në Kosovë në lidhje me çështjet mjedisore dhe sociale?					
	2.1 A e zbaton ndërmarrja parimin e mosdiskriminimit në procesin e					

<p>2. Rishikimi i Kushteve të Punës</p>	<p>punësimit, kompensimit dhe kushteve të punës, duke përfshirë edhe grupet e cenueshme të punonjësve?</p>					
	<p>2.2 A ka ndërmarrja procedura për shëndetin dhe sigurinë në punë?</p>					
	<p>2.3 A u ofron ndërmarrja punonjësve të saj një mjedis pune të sigurt dhe të shëndetshëm?</p>					
	<p>2.4 A ka ndërmarrja programe trajnimi për punonjësit mbi shëndetin dhe sigurinë në punë?</p>					
	<p>2.5 Kur është e aplikueshme, a u siguron ndërmarrja punonjësve pajisje mbrojtëse personale (helmeta, maska, doreza, çizme mbrojtëse,</p>					

	mbrojtje nga zhurma, masa mbrojtëse nga lartësia, etj.) dhe a kërkon/monitoron përdorimin e tyre?					
	2.6 A ofron biznesi trajnime mbi përdorimin e makinerive/pajisjeve?					
	2.7 Në rastin e makinerive/pajisjeve më specifike, a janë vendosur mekanizma mbrojtës që parandalojnë rreziqet gjatë funksionimit?					
	2.8 A i regjistron dhe raporton ndërmarrja nivelet e lëndimeve, sëmundjeve profesionale, ditëve të humbura dhe numrin e vdekjeve në punë? Ju lutemi jepni të dhënat më të fundit?					

	2.9 A është kompania e përfshirë në punë të dëmshme të fëmijëve ose në punë të detyruar (duke përfshirë edhe në zinxhirin e furnizimit)?					
3. Parandalimi i ndotjes në vendin e biznesit/ndërmarrjes	3.1 A zbaton ndërmarrja masa për të përmirësuar efikasitetin në konsumin e energjisë, ujit, lëndëve të para dhe burimeve të tjera?					
	3.2 A gjeneron ndërmarrja emetime në ajër, të lëngshme ose të ngurta gjatë fazave të ndërtimit dhe/ose operimit të aktiviteteve të saj? Nëse po, ju lutemi jepni detaje.					
	3.3 Ju lutemi përshkruani procedurat në fuqi për monitorimin e emetimeve në ajër dhe ujë. Ju					

	lutemi të paraqisni një kopje të çdo lejeje për shkarkimin e ujërave të ndotura.					
	3.4 A ka kompania udhëzime për ruajtjen, trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve të ngurta (përfshirë mbetjet e rrezikshme) që rrjedhin nga biznesi i saj? Nëse po, ju lutemi jepni detaje të shkurtra.					
	3.5 A janë të lidhura rezervuarët e magazinimit të naftës me rezervuarët sekondarë për të parandaluar rrjedhjet?					
	3.6 A ka ndonjë procedurë reagimi për të menaxhuar derdhjet aksidentale?					
	3.7 A ka komunitete që jetojnë pranë					


	<p>ambienteve të kompanisë? A ka kompania procedura për të adresuar çështjet e shëndetit dhe sigurisë së komunitetit në kontekstin e operacioneve të saj?</p>					
	<p>3.8 A ka kompania procedura sigurie për t'u marrë me çlirimin, transportin dhe asgjësimin e materialeve të rrezikshme me qëllim shmangien ose minimizimin e ekspozimit të komuniteteve lokale ndaj këtyre materialeve? Ju lutem përshkruani.</p>					
	<p>3.9 A ka kompania procedura për parandalimin dhe monitorimin e zhurmës gjatë ndërtimit/operimit të saj?</p>					
	<p>4.1 Ju lutemi përshkruani procedurat në</p>					

4. Shëndeti dhe Siguria e Komunitetit	fuqi për t'u angazhuar me komunitetet lokale dhe për të adresuar ankesat e komunitetit, aty ku është e aplikueshme. (p.sh., mekanizmi i zgjidhjes së ankesave, plani i angazhimit të palëve të interesuara).					
Vlerësim i Përgjithshëm i Çështjeve Mjedisore dhe Sociale (Ju lutemi jepni një përmbledhje që trajton menaxhimin e çështjeve kryesore mjedisore, sociale, të sigurisë dhe shëndetit që lidhen me biznesin e klientit)						

Plani veprimit për përmirësimin e ndikimit në mjedis dhe shoqëri - Kjo duhet të përfshihet në marrëveshjen e bankës dhe të monitorohet për pajtueshmëri						
Çështja e identifikuar për përmirësim	Veprimet që do të ndërmerren	Data e përfundimit:		Opinionit ose konkluzionet se a janë veprimet e cekura lehtë të arritshme, të nevojshme dhe a ndikojnë në përmirësim të ndikimit në mjedis këto investimeve(të planifikuara nga klienti/të rekomanduara nga banka)?		
Mbeturinat në lokacion						
Pajisjet mbrojtëse						
Vendosja e skeleve dhe rrjetave						
Makineritë e ndërtimit						
Tjetër						
Personi përgjegjës i bankës:		Nënshkrimi:		Data:	____/____/____ ____	
Udhëzime: - Ju lutemi jepni sa më shumë informacione në seksionin informata shtesë për të mbështetur përgjigjet e dhëna - Për informacione specifike sektoriale mbi rreziqet e mjedisore dhe sociale, ju lutemi referojuni linqeve më poshtë:						

<p>http://firstforsustainability.org/risk-management/understanding-environmental-and-social-risk/risk-by-industry-sector/ http://ifc.org/ehsguidelines</p>	
--	--

Shtojca IV Rjedha Gjenerike e Procesit të Miratimit të Kredisë



1. *Kërkesa për Kredi*: Klienti aplikon për një kredi; formulari i aplikimit dorëzohet së bashku me dokumentet përkatëse;
2. *Analiza e Kredisë*: Mbledhja e dokumenteve / lejeve që mungonin në fazën e aplikimit, plani i investimit duhet të përfshihet;
3. *Kategorizimi Mjedisor*: Në këtë fazë, ndodh kategorizimi mjedisor. Bazuar në planin investiv, kredia mund të kategorizohet si A-jo e pranueshme, B +, B- dhe C. B + kategoritë do të jenë subjekt i miratimit dhe kategorizimit nga FKGK për tri rastet e para të IRF-ve që regjistrohen për herë të parë nga FKGK;
4. *Komiteti i Riskut të Kredisë*: Kredia i paraqitet menaxhmentit të Bankës;
5. *Disbursimi i Kredisë*: Nënshkrimi i kontratës dhe transferimi i fondeve;
6. *Monitorimi dhe Raportimi*: Banka do të monitorojë kreditë dhe ndikimet e tyre mjedisore dhe sociale (nëse ka) dhe do t'i raportojë FKGK-së në rast të mospërputhjeve.

Shtojca V

Projektet e renditura në Shtojcën 1 të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, që i nënshtrohen procedurave të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis

1. Prodhimi dhe procesimi i metaleve

1. Fabrika për pjekjen ose sinterimin e mineraleve metalike (duke përfshirë mineralet që përmbajnë squfur).
2. Fabrika për derdhjen e gizës dhe çelikut (bashkimi primar ose sekondar), duke përfshirë derdhjen e vazhdueshme.
3. Fabrika/fonderi për përpunimin e metaleve të zeza:
 - 3.1. farkëtore me çekan, energjia e të cilave i kalon pesëdhjetë (50) KJ për çekan, ndërsa fuqia kalorike e përdorur i kalon njëzet (20) KW;
 - 3.2. aplikimi i m'veshjeve mbrojtëse me metal të përzier me një kapacitet që i kalon 1 ton të çelikut bruto në orë;
 - 3.3. fonderi të metaleve të zeza me një kapacitet prodhimi mbi njëqind (100) tonë/ditë.
4. Fabrika/fonderi për:
 - 4.1. prodhimin e metaleve me ngjyrë nga mineralet, koncentratet ose lëndët dytësore të proceseve metalurgjike, kimike, elektrolitike;
 - 4.2. shkrirjen, përfshirë legurimin, përfshirë produktet e rikuperuara (rafinimi, derdhja në fonderi, etj.) me një kapacitet shkrirjeje që i kalon një (1) ton në ditë për plumbin dhe kadmiumin ose dhjetë (10) tonë në ditë për të gjitha metalet tjera.
5. Fabrika për trajtim sipërfaqësor të metaleve dhe materialeve plastike, duke përdorur një proces elektrolitik ose kimik në të cilin vëllimi i vaskës për trajtim i kalon dhjetë (10) m.
6. Impiant për trajtimin sipërfaqësor të substancave, objekteve ose prodhimeve, që përdorin tretës organik në veçanti për m'veshje, shtypje, mbiveshje, çyndyrësim kundër depërtimit të ujit, ngjyrosje, pastrim ose ngjeshje me një kapacitet më të madh se njëqind (100) tonë/vit.
7. Prodhimi dhe përpunimi i legurave nga metalet me ngjyrë që përmbajnë arsen, merkur dhe plumb me kapacitet më të lartë se njëmijë (1000) tonë në vit.

2. Industria e mineraleve

8. Fabrika për prodhimin e çimentos në furra rrotulluese (pjekje dhe tharje) me një kapacitet prodhues që i kalon treqind (300) tonë në ditë ose për prodhimin e gëlqeres në furra rrotulluese me një kapacitet prodhues që i kalon tridhjetë (30) tonë në ditë ose në furnalta të tjera me një kapacitet prodhues që i kalon tridhjetë (30) tonë në ditë.
9. Fabrika për prodhimin e materialeve me procesin e kalcinimit dhe pjekjes së mineraleve që përmbajnë elemente toksike si merkur, arsen dhe kadmium.
10. Fabrika për prodhimin e qelqit, përfshirë fibrat e qelqit me një kapacitet shkrirjeje që i kalon dhjetë (10) tonë në ditë.

11. Fonderi për shkrirjen e substancave minerale, përfshirë prodhimin e fibrave minerale me kapacitet që i kalon dhjetë (10) tonë në ditë.

12. Fabrika për prodhimin e qeramikës me anë të zjarrit e në veçanti tjegulla, tulla, tulla refraktare ose porcelani, me një kapacitet prodhues që i kalon tridhjetë (30) tonë në ditë.

13. Repartet për nxjerrjen e asbestit, repartet për përpunimin dhe transformimin e asbestit dhe të prodhimeve që përmbajnë asbest: për produktet asbest-çimento, me një prodhim vjetor prej më shumë se pesëmijë (5000) tonë të prodhimeve finale, për materialet fërkuese, me një prodhim vjetor prej pesëdhjetë (50) tonë të produkteve finale, dhe për përdorimet tjera të asbestit, sasia e prodhimit e të cilave kalon dyqind (200) tonë në vit.

14. Fabrika për pjekjen dhe sinterimin e mineraleve jometalike me kapacitet të prodhimit që i tejkalon tridhjetë (30) tonë/ditë.

3. Industria ekstraktuese

15. Gurore dhe miniera të hapura, në sipërfaqe më të madhe se pesë (5) ha, nxjerrje të torfës, në sipërfaqe më të madhe se dhjetë (10) ha ose nxjerrja e më tepër se pesëmbëdhjetëmijë (15.000) tonë/vit.

16. Nxjerrja dhe përpunimi (me përjashtim të lëngëzimit dhe gazifikimit) i qymyrit, i linjtit dhe i mineraleve bitumene me kapacitet më të lartë se pesëdhjetëmijë (50.000) tonë në vit.

4. Industria kimike

17. Aktivitete të integruara për prodhimin në shkallë industriale të substancave ose grupeve të substancave të cekura në nën- paragrafët 17.1 deri në 17.7 me anë të proceseve kimike: 17.1. Për prodhimin e kimikateve organike themelore, si:

17.1.1. hidrokarbure të thjeshta (lineare ose ciklike, të ngopura ose të pangopura, alifatike ose aromatike);

17.1.2. hidrokarbure që përmbajnë oksigjen, si: alkoole, aldehide, ketone, acide karboksilike, etere, perokside, rrëshira epoksi;

17.1.3. hidrokarbure që përmbajnë sulfur;

17.1.4. hidrokarbure që përmbajnë azot, si: amine, amide, nitro komponime, komponime nitratësh, nitrile, cianure, izocianate;

17.1.5. hidrokarbure që përmbajnë fosfor;

17.1.6. hidrokarbure halogjene; 17.1.7. komponime organometalike;

17.1.8. materiale plastike bazë, (fibra sintetike polimerike dhe fibra me bazë celuloze);

17.1.9. goma sintetike;

17.1.10. ngjyra dhe pigmente;

17.1.11. agjent aktiv sipërfaqësor.

17.2. Për prodhimin e kimikateve inorganike themelore si:

17.2.1. gaze si: amonjaku, klori ose gazi klorhidrik, fluori ose gazi fluorhidrik, dioksidi i karbonit, përbërësit e squfurit, dioksidi i squfurit, hidrogjeni, kloruri i karbonilit;

17.2.2. acide si: acidi kromik, acidi fluorhidrik, acidi fosforik, acidi nitrik, acidi klorhidrik, acidi sulfurik, oleumi dhe acidi sulfuror;

17.2.3. baza si: hidroksidi i amonit, hidroksidi i kaliumit, hidroksidi i natriumit;

17.2.4. kripërat si: karbonati i kaliumit, karbonati i natriumit, perboratet, nitrati i argjendit;

17.2.5. jo metale, okside të metaleve ose komponime të tjera inorganike si karburi i kalciumit, silici, karburi i silicit.

17.3. për prodhimin e plehrave kimike me bazë fosfatike, azotike ose të kaliumit (plehra kimike të thjeshta ose të përbëra);

17.4. për prodhimin e produkteve themelore për mbrojtjen e bimëve dhe të biocideve;

17.5. impiante që përdorin proceset kimike ose biologjike për prodhimin e produkteve me bazë farmaceutike, ngjyrave dhe pesticideve;

17.6. për prodhimin e lëndëve shpërthyesë;

17.7. për prodhimin e shtesave ushqimore proteinike, fermente dhe substanca të tjera proteinike me rrugë kimike ose biologjike;

17.8. Impiantet për trajtimin e kimikateve të mbeturinave.

5. Industria energjetike

18. Termocentrale për prodhim të energjisë dhe impiante të tjera djegëse me prodhim të energjisë më të lartë se pesëdhjetë (50) MW.

19. Centrale të energjisë nukleare.

20. Ndërtimi i linjave elektrike të tensionit të lartë me një voltazh minimumi dyqindnjëzet (220) KV dhe me një gjatësi më të madhe se dhjetë (10) km.

21. Rafineritë e naftës dhe gazit, pajisjet për lëngëzim dhe gazifikim të qymyrit dhe rërave bituminoze, impiante për rigjenerimin e vajrave të përdorur me sasi më të lartë se njëqindmijë (100.000) tonë/vit.

22. Depo për ruajtjen dhe depozitimin e naftës, produkteve të saj, produkteve kimike dhe petrokimike me kapacitet më të lartë ose të barabartë me njëqindmijë (100.000) tonë.

23. Depo për ruajtjen dhe depozitimin e materieve radioaktive.

6. Infrastruktura e transportit

24. Ndërtimi i linjave për trafikun hekurudhor në distancë të gjatë dhe për aeroporte me rrugë kalimi bazë më të madhe ose të barabartë me dymijënjëqind (2100) m.

25. Ndërtimi i një rruge të re me dy ose më shumë shirita ose zgjerimi i një rruge ekzistuese me dy ose më pak shirita ku do të sigurohen dy ose më shumë shirita, ku kjo rrugë e re ose pjesa e zgjeruar e rrugës do të jetë pesë (5) km ose më shumë në vazhdimësi.

26. Tubacionet me diametër prej pesëqind (500) mm ose mbi këtë vlerë dhe një gjatësi prej dhjetë (10) km ose mbi këtë vlerë për transportin e:

26.1. gazit natyror, produkteve të naftës ose kimikateve;

26.2. dioksidit të karbonit (CO₂) për qëllime të deponimit gjeologjik, përfshirë edhe stacionet shoqëruese të pompimit.

27. Tubacionet me diametër më të madh se tetëqind (800) mm dhe një gjatësi më të madhe se dyzet (40) km për transportin e dioksidit të karbonit (CO₂) për qëllime të deponimit gjeologjik, përfshirë edhe stacionet shoqëruese të pompimit.

7. Industria ushqimore

28. Trajtimi dhe përpunimi i synuar për prodhimin e produkteve ushqimore nga:

28.1. lëndët e para me origjinë shtazore (përveç qumështit) me kapacitet të prodhimit final më të madh se tridhjetë (30) tonë/ditë;

28.2. lëndët e para bimore me kapacitet të prodhimit final më të madh se dyqindpesëdhjetë (250) tonë/ditë;

28.3. trajtimi dhe përpunimi i qumështit, në sasi prej njëqind (100) tonë/ditë (vlera mesatare mbi bazë vjetore);

28.4. Fabrikat për përpunimin e mishit.

8. Trajtimi i mbeturinave dhe ujërave të shkarkuar

29. Impiante për djegie, rikuperim, trajtim kimik, ose deponim të mbeturinave të rrezikshme.

30. Impiante për djegien e mbeturinave urbane me kapacitet më të madh se një (1) ton/orë.

31. Deponitë e mbeturinave urbane me kapacitet më të madh se tridhjetë (30) tonë/ditë.

32. Impiantet e trajtimit të ujërave urbane të shkarkuara me kapacitet ekuivalent ose më të madh, për njëqindmijë (100.000) banorë.

33. Impiantet e trajtimit të ujërave industriale të shkarkuara.

9. Projektet për depozitim, transport dhe furnizim të ujit

34. Nxjerrja e ujërave nëntokësor ose skemat artificiale të ringarkimit të ujërave nëntokësor, ku vëllimi vjetor i ujit të nxjerr ose të rimbushur (ringarkuar) është i barabartë ose më i madh se pesë (5) milion m³:

34.1. Punime për transferimin e burimeve ujore nga basenet e lumenjve, ku transferimi synon të rrugëkalimet e shkurtuara parandaluese të ujërave dhe ku sasia e ujërave të transferuara është më e madhe se tridhjetë (30) milion m³ /vit:

34.2. Në të gjitha rastet punimet për transferimin e burimeve ujore nga basenet e lumenjve, ku rrjedha shumëvjeçare e basenit është më e madhe se gjashtëqind (600) milion m³ /vit dhe ku sasia e ujërave të transferuara është më e madhe se 5 për qind e kësaj rrjedhjeje. Në të dyja rastet përjashtohet transferimi i ujit të pijshëm me tubacione.

35. Pendat dhe rezervuaret e tjera të projektuara për grumbullimin ose depozitimin e ujit, ku sasia shtesë e ujit është më e madhe se pesë (5) milionë m³ .

10. Industria e letrës, e drurit, e tekstilit, dhe e lëkurës

36. Prodhimi i fibrave të kartonit mbi njëqindmijë (100.000) m² /vit.

37. Impiante industriale për: 37.1. prodhimin e pulpës nga druri ose fibrave të tjera të ngjashme;

37.2. prodhimin e letrës dhe kartonëve me kapacitet prodhues më të madh se pesëdhjetë (50) tonë/ditë.

38. Prodhimi i mobileve me kapacitet mbi dhjetëmijë (10.000) m³ /vit, lëndë e parë.

39. Impiantet për trajtimin paraprak (operacione të tilla si larja, zbardhja, mercerizimi), ose ngjyrosjen e fibrave dhe tekstileve.

40. Fabrika për trajtimin dhe përpunimin e lëkurës.

11. Bujqësia intensive

41. fermë për rritjen intensive (të shpejtë) të shpezëve, derrave dhe bagëtime të imëta që kanë më shumë se:

41.1. dhjetëmijë (10.000) shpendë (shpezë);

41.2. pesëqind (500) derra;

41.3. njëqind (100) gjedhe;

41.4. njëmijë (1000) bagëti të imëta.

12. Projekte të tjera

42. Impiant për depozitimin ose trajtimin e mbeturinave të kafshëve dhe të skeleteve të kafshëve.

43. Zonat e deponimit për deponim gjeologjik të dioksidit të karbonit.

44. Instalime për kapje të vrushkujve të CO₂ për qëllime të deponimit gjeologjik nga instalimet e përfshira nga kjo Shtojcë, ose në rastet kur kapja e përgjithshme vjetore e CO₂ është 1,5 megaton ose mbi këtë vlerë.

45. Çdo ndryshim ose zgjatje e ndonjë projekti të paraqitur në këtë Shtojcë, kur ndryshimi ose zgjatja e tillë e arrin pragun e caktuar në këtë Shtojcë, nëse një i tillë është i përfshirë.

Shtojca VI

Projektet e renditura në Shtojcën II të Ligjit kombëtar të Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor

1. Bujqësia, Pylltaria dhe Peshkataria

- 1.1. Projekte për përdorimin e tokave jobujqësore ose zonave gjysmë natyrore për qëllime të bujqësisë intensive;
- 1.2. Projekte të menaxhimit të ujërave për nevoja bujqësore duke përfshirë projektet e ujitjes dhe drenazhimit të tokës;
- 1.3. Pyllëzimi dhe shpyllëzimi për qëllimet e ndryshimit të destinacionit të përdorimit të tokës;
- 1.4. Fermat intensive të peshkut.

2. Industria ekstraktuese

- 2.1. Gurore, gurthyes, miniera të hapura dhe nxjerrje torfe përfshirë këtu vendet e identifikuar për punime të zejeve (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën 1);
- 2.2. Minime nëntokësore;
- 2.3. Nxjerrja, thërmimi dhe seperimi e mineral-inerteve nga drenazhimi lumor;
- 2.4. shpimet e thella në veçanti:
 - 2.4.1. shpimet gjeotermike;
 - 2.4.2. shpimet për furnizimet me ujë, duke përjashtuar shpimet për të kontrolluar qëndrueshmërinë e tokës.
- 2.5. objekte sipërfaqësore industriale për nxjerrjen e qymyrit, linjtit dhe materialeve bituminoze (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën 1).

3. Industria Energjetike

- 3.1. impiantet industriale për prodhimin e energjisë elektrike, avullit dhe ujit të nxehtë (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën 1);
- 3.2. impiante industriale për mbajtjen e gazit, avullit, ujit të nxehtë; për transmetimin e energjisë elektrike me anë kabllorsh (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën 1);
- 3.3. ruajtja në sipërfaqe e gazit natyror;
- 3.4. ruajtja nën tokë e gazeve të djegshme;
- 3.5. ruajtja mbi dhe nën sipërfaqe të tokës e lëndëve të djegshme të lëngëta (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën 1) dhe ruajtja në sipërfaqe të tokës e karburanteve fosile;
- 3.6. briketimi industrial i qymyrit dhe i linjtit;
- 3.7. hidrocentrale (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën 1);
- 3.8. pajisjet për shfrytëzimin e fuqisë së erës për prodhimin e energjisë;
- 3.9. Burimet rrezatuese të vazhdueshme (jonizuese dhe jojonizuese);
- 3.10. Instalime për kapje të vrushkujve të CO2 për qëllime të deponimit gjeologjik (instalime që nuk përfshihen në Shtojcën 1).

4. Prodhimi dhe Përpunimi i Metaleve

- 4.1. Prodhimi i hekurit dhe çelikut me derdhje të vazhdueshme;
- 4.2. Impiant për përpunimin e metaleve të zeza (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën 1);
- 4.3. Fonderi të metaleve të zeza (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën 1);
- 4.4. Impiant për shkrirjen, përfshirë legurimin e metaleve me ngjyrë, me përjashtim të metaleve të çmuara, duke përfshirë produktet e rikuperuara (rafinimi, derdhja në fonderi, etj.), (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën 1);
- 4.5. Impiant për trajtim sipërfaqësor të metaleve dhe materialeve plastike (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën 1);
- 4.6. Prodhimi dhe montimi i automjeteve dhe prodhimi i motorëve për automjete;
- 4.7. Impiante për pjekjen dhe sinterimin e mineraleve metalike;
- 4.8. Instalimet për ndërtimin dhe riparimin e aeroplanëve;
- 4.9. Prodhimi i pajisjeve hekurudhore;
- 4.10. Copëtimi me eksplozivë.

5. Industria e Mineraleve

- 5.1. Furrat e koksit (distilimi i thatë i qymyrit); (i qymyrit të thatë);
- 5.2. Fabrika për prodhimin e çimentos (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën 1);
- 5.3. Fabrika për prodhimin e azbestit dhe për përpunimin e produkteve të azbestit (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën 1);
- 5.4. Fabrika për prodhimin e qelqit dhe të fibrave të qelqit (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën 1);
- 5.5. Fonderi për shkrirjen e substancave minerale që përfshinë edhe fibrat minerale (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën 1);
- 5.6. Prodhimi i produkteve qeramike me anë të djegies, në veçanti tjegulla çatie, tulla, tulla refraktare, tjegulla, veshje guri ose porcelani (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën 1);
- 5.7. Fabrika për prodhimin e asfaltit;
- 5.8. Fabrika për prodhimin e betonit.

6. Industria Kimike

- 6.1. trajtimi i mes produkteve dhe prodhimi i kimikateve;
- 6.2. prodhimi i pesticideve dhe produkteve farmaceutike, ngjyrave dhe varakut, elastomereve dhe peroksideve (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën 1);
- 6.3. objektet e magazinimit për qëllime tregtie apo ruajtjeje së naftës, produktet e naftës dhe produktet kimike.

7. Industria Ushqimore

- 7.1. Prodhimi i vajrave dhe yndyrave shtazore dhe bimore (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën 1);
- 7.2. Paketimi dhe ambalazhimi i produkteve bimore dhe shtazore;
- 7.3. Prodhimi i produkteve bulmetore (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën 1);
- 7.4. Prodhimi i birrës dhe maltimi (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën 1);
- 7.5. Prodhimi i shurupeve dhe ëmbëlsirave (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën 1);
- 7.6. Instalimet për therjen e kafshëve;
- 7.7. Instalime industriale për prodhimin e niseshtesë;
- 7.8. fabrikat e sheqerit (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën 1).

8. Industria Tekstilit, Lëkurës, Drurit dhe Letrës

- 8.1. Fabrikat për prodhimin e letrës dhe kartuçit (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën 1);
- 8.2. Impiante për paratrajtimin (larja, zbardhja, mercerizimi) ose lyerja e fibrave dhe tekstileve (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën 1);
- 8.3. Impiante për regjien e gëzofit dhe lëkurës;
- 8.4. Impiante për përpunimin dhe prodhimin e celulozës.

9. Industria e Gomës

- 9.1. Prodhimi dhe trajtimi i produkteve me bazë elastomeri.

10. Projektet e Infrastrukturës

- 10.1. Projekte të zhvillimit industrial;
- 10.2. Projekte të zhvillimit urban, duke përfshirë ndërtimin e qendrave tregtare dhe parkingjeve të automjeteve;
- 10.3. Ndërtimi i hekurudhave, pajisjeve intermodale të transportit dhe terminaleve intermodale (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën 1);
- 10.4. Ndërtimi i aeroporteve dhe fushave për aeroplanët e vegjël (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën 1);
- 10.5. Ndërtimi i rrugëve (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën 1);
- 10.6. Ndërtimi, konstruktimi ose modifikimi i kanaleve ujore në tokë, projekte për kanale dhe parandalim të rrjedhjes;
- 10.7. Projekte për parandalim të përmytjeve përfshirë modifikimin e kanaleve të lumenjve (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën 1);

- 10.8. Pendët ose instalime të tjera të projektuara për të mbajtur ujë ose për ta ruajtur atë për një kohë të gjatë (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën 1);
- 10.9. Konstruktimi ose modifikimi i binarëve të tramvajeve, i ashensorëve ose hekurudhave nëntokësore, që përdoren vetëm ose kryesisht për pasagjerë;
- 10.10. Instalime tubacioni për naftë dhe gaz dhe tubacione për transport të vrushkujve të CO2 për qëllime të deponimit gjeologjik (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën 1);
- 10.11. Nxjerrja e ujërave nëntokësore dhe skemat e rimbushjes artificiale të ujërave nëntokësore (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën 1);
- 10.12. Puna për transferimin e burimeve ujore midis baseneve të lumenjve (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën 1).

11. Turizmi dhe Koha e Lirë

- 11.1. Shtigje skijimi, teleferikë, makina me kablo dhe zhvillime të shoqëruara me këto lloj veprimtarish;
- 11.2. Fshatra turistike dhe komplekset e hoteleve jashtë zonave urbane dhe objekteve të shoqëruara me këto lloj veprimtarish;
- 11.3. Vende (zona) të karvanëve dhe kampeve;
- 11.4. Parqe zbavitëse;
- 11.5. Objektet e infrastrukturës në zonat e mbrojtura që nuk janë të përfshira në planin hapësinor.

12. Projekte të Tjera

- 12.1. Rrugë permanente që përdoren për testimin dhe garat e mjeteve të motorizuara;
- 12.2. Instalime për eliminimin e plehrave (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën I);
- 12.3. Impiante për trajtimin e ujërave të ndotura (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën I);
- 12.4. Instalime për grumbullimin e llumit (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën I);
- 12.5. Depo për ruajtjen e mbeturinave të hekurit dhe të metaleve të tjera, duke përfshirë skeletet metalike të makinave të dala jashtë përdorimit;
- 12.6. Instalime për prodhimin e fibrave minerale artificiale (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën I);
- 12.7. Instalime për rikuperimin ose shkatërrimin e substancave eksplozive;
- 12.8. Vende për depozitim të mbetjeve industriale jo të rrezikshme;
- 12.9. Vende që përdoren për grumbullimin-depozitim të kafshëve të ngordhura ose të padëshirueshme (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën 1);
- 12.10. Industri ushqimore (projekte që nuk bëjnë pjesë në Shtojcën 1 ose në seksionin 7 më lartë);
- 12.11. Çdo ndryshim ose zgjerim i projekteve të dhëna në Shtojcën 1 ose Shtojcën 2, të cilat janë të lejuara, të realizuara ose në proces të realizimit, të cilat mund të kenë ndikime të theksuara jo të favorshme në mjedis (ndryshimi ose zgjerimi që nuk është përfshirë në Shtojcën I);
- 12.12. Projektet në Shtojcën 1, të ndërmarra ekskluzivisht ose kryesisht për zhvillim ose testim të metodave ose produkteve të reja dhe që nuk janë përdorur për më tepër se dy (2) vite.

Shtojca VII

Lista e aktiviteteve që i nënshtrohen Lejes Mjedisore Komunale

1. Autoserviset;
2. Autolarjet;
3. Autoserviset me automjete jashtë përdorimit deri në 20 copë;
4. Stacionet e karburanteve të gazit (GLN) deri 5 m³;
5. Stacionet e karburantëve me kapacitet deri 50 m³;
6. Sharrë për lëndë drunore;
7. Fabrikat për përpunim druri, mobileri, tapiceri deri 1000m³/vit
 7. Furra për prodhim të bukës dhe produkteve tjera nga mielli;
8. Ndërtimi dhe rehabilitimi i rrjetit të kanalizimit të ujërave të zeza në gjatësi deri 5 km;
9. Ndërtimi dhe rehabilitimi i rrjetit të ujësjellsit, në gjatësi deri 5 km;
 8. Riparimi i rrugëve urbane ekzistuese dhe ndërimi i akseve të reja rrugore (me gjatësi deri në 5 km);
10. Mishtoret;
11. Prodhimi i gëlqerës së shuar;
12. Prodhimi i betonit dhe elementeve parafabrikate, pllakave etj. me kapacitet të projektuar deri në 2 m³ beton/orë;
13. Qendra për grumbullimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimit, për Komunitat të cilat kanë më pak se 60.000 banorë;
14. Rritje artificiale e peshkut në hurdha, me sipërfaqe deri në 300 m²;
15. Pishinat, pa objekte hoteliere dhe objekteve përcjellëse;
16. Punishtet për përpunim të mermerit;
17. Ndërtimi i objekteve të banimit kolektiv dhe të shërbimeve (hoteliere, tregtare, komerciale, afariste, etj.) me sipërfaqe në bazë mbi 450 m² ose në sipërfaqen totale të objektit mbi 1500 m²;
18. Veprimtaria e prodhimit të kompostit, me sasi totale përpunimi deri 100 m³ ose 40 ton/vit;
19. Depoja për plehra kimike dhe pesticide;
20. Objektet shërbyese për ushqime (qebaptore, ëmbëltore, gjelltoje, restaurante etj);
21. Vendet apo qendrat për mbledhje dhe grumbullim të mbeturinave, ku magazinohen mbeturinat inerte (plastikë, letër dhe qelq), në sasi deri 30 t;
22. Impiantët për rritjen intensive të shpezëve, bagëtime të imta dhe të mësha që kanë më pak se: 5000 shpend; 250 derra; 50 gjedha; 500 bagëti të imëta;
 9. Paisjet për shfrytëzimin e fuqisë së erës për prodhimin e energjisë, me fuqi instaluese deri në 100 kW/orë;
23. Sistemet solare me sistemet fotovoltaike të prodhimit të energjisë/avullit, deri në 100kW/orë;
24. Stacionet e telefonisë mobile;
 10. Vendet e tregimit të kafshëve në vende të hapura dhe të mbyllura;
25. Pikat e magazinimit dhe tregimit të materialeve të ndërtimit;
26. Qendrat zejtare;
27. Serviset (servisimi i paisjeve teknike dhe elektronike);
28. Studiot fotografike;
29. Prodhimi i dymave dhe dritareve të plastikës;